
AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“SPLENDIDENT” Sh.p.k.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi tekufizuar “SPLENDIDENT” Sh.p.k. dhe zoterohet nga ortaku:

- 1. Orsjola Xhaja**, atesia . Thimio, shtetas shqiptar, lindur me 05.04.1974 ne Tirane, banues ne Tirane,identifikuar nepermjet kartes se identitetit Nr. H45405070P.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “SPLENDIDENT”Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

NENI 1
FORMA DHE EMRI

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise eshte “SPLENDIDENT” Sh.p.k.

NENI 2 BAZA
LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacioninshqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

NENI 3
SELIA

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga Haxhi Dalliu, Ndertesa 46, Hyrja 9, Ap. 6 1016 Tirane Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brendaose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4
KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet me vendim tëAsamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakeve ose kur ka prishje të hershme për arsytet e parashikuara nga ligji.

NENI 5
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “SPLENDIDENT” Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqerie dhe ka si objekt të veprimtarise së saj:

5.1 Sherbime stomatologjie.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 Leke (njqindmije), i ndare në 1(nje)pjese.
Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1- Orsjola Xhaja 100 % - 100.000 LEKE

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne nje llogari tëhapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7 AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si itillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Si rezultat i ndryshimeve që mund t'i ndodhin kompanisë në të ardhmen dhe rritjes së numrit të ortakeve, tani dhe me vone, trupi që mban kapitalin aksionar të kompanisë do t'i referohet termit "Asambleja e Ortakeve".

Shoqeria mund te percaktoje me shume se nje Administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "SPLENDIDENT" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer.

Përveç organeve të parashikuara më sipër Asambleja e Ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator i shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emruar Znj. Orsjola Xhaja, identifikuar nga Karta Identitetit Nr. H45405070P

NENI 9 DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 2 (dy) kopje, duke patur secili kopje fuqi të njëjtë ligjore.
Tirane, 01.08.2023

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE

"SPLENDIDENT" Sh.p.k.

Orsjola Xhaja

AKT THEMELIMI "SPLENDIDENT" Sh.p.k.

Pag. 2 a2